

URDHËR
Nr.300, datë 8.5.2020

**“PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE STOMATOLOGJIKE NË
KLINIKA/KABINETE DENTARE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr.15/201, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ligjit nr. 9106, datë 17.0.2003 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Hapjen e klinikave/kabineteve dentare, në të gjithë vendin, duke filluar nga data 11 maj 2020 dhe ofrimin e shërbimeve brenda fashës orare 08:00-17:30, duke respektuar protokollin e sigurisë, të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij urdhri.

3. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrit dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Urdhri nr. 165, datë 12.0.2020 “Për mbylljen e klinikave/kabineteve dentare”, shfuqizohet. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu